



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 maj 2019
Nr.ref.:RK 1359/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. 159/18

Parashtrues

Azem Duraku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 277/2017, të 30 prillit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Azem Duraku, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [PML nr. 277/ 2017] të Gjykatës Supreme, të 30 prillit 2018, me të cilin është refuzuar kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur kundër Aktvendimit [PN. nr. 191/2016] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 1 prillit 2016.
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 qershor 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 102 (3) [Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit], nenin 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendos masë të përkohshme *“në mënyrë që procedura penale në Gjykatën Themelore të pezullohet deri në vendimmarrjen nga Gjykata Kushtetuese, sepse konsiderojmë se kjo masë është e nevojshme për të evituar dëmet e pariparueshme të cilat nuk mund të riparohen me vonë, duke vazhduar me mbajtjen e seancave të shqyrtimit gjyqësor.”*

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe rregullin 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 13 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatë.
8. Më 23 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
9. Më 30 tetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 13 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkesës të cilin e kishte dorëzuar më 16 tetor 2018.
11. Më 3 prill 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Gjykata, në fillim, rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar një herë kërkesë në Gjykatë, e cila më 7 prill 2016 është regjistruar nga Gjykata me shenjën KI60/16. Gjykata në lidhje me kërkesën KI60/16 kishte vendosur me Aktvendim për papranueshmëri të 15 nëntorit 2016.
13. Po ashtu, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës në Gjykatë, edhe në këtë kërkesë KI159/18 vjen me një gjendje pothuajse identike faktike, të cilën Gjykata do ta prezantojë në mënyrë kronologjike në këtë raport.
14. Më 5 tetor 2012, Prokurori Special (në tekstin e mëtejshëm: PS) nxori Aktvendimin për inicimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës dhe gjashtë personave të tjerë, duke pretenduar që kanë kryer disa vepra penale (*Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, duke shkelur nenin 339, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së*).
15. PS disa herë nxori vendime për zgjerimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve të tjerë, si në vijim:
16. Më 15 mars 2013, PS nxori vendimin për zgjerimin e hetimeve.
17. Më 12 nëntor 2013, PS paraqiti propozimin për vazhdimin e hetimeve.
18. Më 10 prill 2014, PS sërish paraqiti propozimin për vazhdimin e afatit të hetimeve.
19. Më 20 nëntor 2014, PS paraqiti propozimin e ri për vazhdimin e afatit të hetimeve.

20. Më 16 dhjetor 2014, gjyqtari i procedurës paraprake në mënyrë retroaktive e vazhdoi afatin e hetimeve deri më 16 janar 2015 kundër parashtruesit të kërkesës.
21. Kundër aktvendimit për vazhdimin e hetimeve, ankesën e paraqiti përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të kërkesës.
22. Gjykata e Apelit miratoi ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se hetimet në fjalë kanë skaduar më 5 tetor 2014.
23. Më 16 janar 2015, PS ngriti Aktakuzën PPS 97/12, në lidhje me këtë rast penal.
24. Më 10 shkurt 2015, u mbajt shqyrtimi fillestar për këtë rast penal. Parashtruesi i kërkesës gjatë shqyrtimit fillestar kontestoi provat dhe kërkoi refuzimin e aktakuzës.
25. Më 11 qershor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PKR. nr. 18/2015, refuzoi kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me pranimin e provave dhe në këtë mënyrë vërtetoi Aktakuzën PPS 97/12, të 16 janarit 2015.
26. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës brenda afatit paraqiti ankesën në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore PKR. nr. 18/2015, të 11 qershorit 2015, duke pretenduar se *“aktakuza PPS nr. 97/2012 e ngritur më 16.01.2015 është e paafatshme dhe në kundërshtim me nenin 159 (10) të KPP-së. Ai thekson se aktakuza duhet të hedhet poshtë si e paafatshme dhe se procedura penale kundër të pandehurit duhet menjëherë të ndërpritet.”*
27. Më 5 gusht 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PN. 365/15, me të cilin e aprovoi pjesërisht ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me afatin e ngritjes së aktakuzës; i refuzoi si të pabazuara kundërshtimet e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës lidhur me pranueshmërinë e provave; e ndryshoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me Aktakuzën PPS 97/12, të 16 janarit 2015, duke vërtetuar se ajo është ngritur pas afatit të përcaktuar në nenin 159 (1) të KPP-së. Në konkludim, Gjykata e Apelit e ndërpreu procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës me arsyetimin *“se aktakuza PPS 97/12, e datës 16 janar 2015, është e paafatshme.”*
28. Më 9 shtator 2015, PS paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se ka shkelje të shumë neneve të KPP-së:
29. Më 26 nëntor 2015, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin PML-KZZ-242/15, me të cilin e aprovoi ankesën e PS dhe e ndryshoi vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

“Është e qartë se afati për ngritjen e aktakuzës nuk është përcaktuar në mënyrë specifike në KPP. As edhe një dispozitë e KPP-së nuk tregon në

hollësi asnjë rrethanë se kur aktakuza është “jashtë afatit” ose rrethanat për hedhjen poshtë të aktakuzës mbi këtë bazë. Paneli me shumicë votash konstatoi se nuk kishte afat kohor për ngritjen e aktakuzës. “Aktakuza është jashtë afatit” nuk parashikohet në KPP. Prokurori i Shtetit kufizohet vetëm përmes parashkrimit të veprës penale në fjalë. Megjithatë, prokurorit të shtetit i rekomandohet qartë që të ngre një aktakuzë sa më shpejt që të jetë e mundur pas përfundimit të hetimeve, pasi rreziku i shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme rritet me kalimin e kohës. Për më tepër, kjo gjykatë me rastin e marrjes së vendimit mbi bazueshmërinë e akuzës penale lidhur me vendimin mbi dëmin gjithmonë do të merr parasysh kohëzgjatjen e procedurës penale, në tërësinë e saj.”

30. Më 7 prill 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, e cila është regjistruar me shenjën KI60/16.
31. Parashtruesi në kërkesën KI60/16, kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML-KZZ-242/2015, të 26 nëntorit 2015, me të cilin pretendonte se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
32. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën KI60/16 gjithashtu kërkoi nga Gjykata të vendos masën e përkohshme, përkatësisht ndërprerjen e procesimit të mëtejshëm penal të rastit në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
33. Më 15 nëntor 2016, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI60/16. Me këtë Aktvendim, Gjykata njëzëri vendosi që ta deklarojë të papranueshme kërkesën e parashtruesit.
34. Gjykata më tej vëren se derisa kërkesa KI60/16 ishte në procedurën e vendimmarrjes në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata Themelore më 9 shkurt 2016, mbajti seancën shqyrtuese në të cilën nxori Vendimin PKR. nr. 18/2015, lidhur me vazhdimin e procedurës gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës.
35. Më 13 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vazhdimin të procedurës gjyqësore.
36. Më 1 prill 2016 Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PN. nr. 191/2016, me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme. Në arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit theksohet: “Gjykata vëren se pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit është se Gjykata Themelore në seancën paraprake nxori Vendimin PKR-18/2015 të vazhdojë procedurën për vërtetimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, një lloj i tillë i ankesës nuk ka ndonjë bazë ligjore në nenin 450 të KPPK-së, dhe rrjedhimisht, ankesa hudhet si e papranueshme, në pajtim me nenin 415.3 dhe 460.2 të KPPK-së.”

37. Më 12 tetor 2017, PS me parashtresën KMLP. II. nr. 192/2017, paraqiti përgjigjen e tij kundër kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, duke propozuar që kërkesa të refuzohet si e papranueshme.
38. Më 30 prill 2018, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin PML. nr. 277/2017, me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të papranueshme. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, theksohet:

“Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, sipas nenit 432, paragrafi 1 të KPP-së, paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se edhe në këtë kërkesë KI159/18, ai pretendon shkelje të neneve të njëjta të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, të cekura edhe në kërkesën KI60/16, dhe ato pretendime kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenet 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 102 (3) [Gjykata gjykon në bazë të Kushtetutës dhe ligjit], neni 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
40. Po ashtu, Gjykata më tej vëren se parashtruesi edhe në kërkesën KI159/18 pretendon se gjykatat kanë shkelur Kodin e Procedurës Penale nr. 04/L-123 përkatësisht nenet 156, 158 (3), 159 (1), 445 (1) dhe (2) të KPP-së, të cilat nuk lejojnë vazhdimin e procedurës penale në dëm të të pandehurit, ose të iniciohet prapë procedura penale për shkak të ekzistencës së afateve prekluzive për ngritje të aktakuzës. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës përmendi disa nene të KPP-së, të cilët ai konsideroi se ishin shkelur nga gjykatat e rregullta.
41. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se vetë vazhdimi i procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në lidhje me vërtetimin e përgjegjësisë së tij penale duhet të pezullohet dhe kjo për arsye se Aktakuza PPS 97/12, të 16 janarit 2015, të cilën e ka ngritur PS, është parashkruar. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi për tu vazhduar më tej me procedurë në Gjykatën Themelore është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale.
42. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të: **a)** vërtetojë që ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, **b)** ta deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 277/2017, të 30 prillit 2018, **c)** ta pezullojë procedurën penale kundër tij, dhe

d) të vërtetojë që vepra për të cilën ai akuzohet në rastin konkret nuk përbën vepër penale.

43. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendos masë të përkohshme me të cilën do të ndalohet seanca në Gjykatën Themelore deri sa Gjykata ta nxjerrë vendimin.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

44. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara me Ligj dhe të përcaktuara më tej me Rregullores të punës.

45. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

46. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor....”

47. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, ... nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata...”

48. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

49. Sa i përket plotësimit të këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, dhe se konteston një akt te autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 277/2017, të 30 prillit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka precizuar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendon se janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kërkesën e ka dorëzuar në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
50. Gjykata në fillim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me kërkesën KI159/18, rikujton se parashtruesi tashmë ka dorëzuar kërkesë në Gjykatë dhe atë më 7 prill 2016 dhe se këtë kërkesë Gjykata e ka regjistruar me shenjën KI60/16.
51. Gjykata më tej rikujton se kërkesa e parashtruesit (KI60/16) kishte të bënte vetëm me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme PML-KZZ-242/15 të 26 nëntorit 2015, me të cilin Gjykata Supreme e anuloi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN. 365/15, të 5 gushtit 2015, dhe me këtë procedura në lidhje me vërtetimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës kishte mundur të vazhdohet.
52. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme PML-KZZ-242/15 atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], 36 [E Drejta e Privatësisë], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 102 (3) [Gjykata gjykon në bazë të Kushtetutës dhe ligjit], 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
53. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës konsideronte se Gjykata Supreme ka shkelur disa nene të KPP-së, të cilët përcaktojnë afatet prekluzive për ngritjen e aktakuzës.
54. Gjykata duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, gjen se ai edhe në këtë kërkesë KI159/18 ngriti përsëri pretendime identike, si në lidhje me shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe të drejtave të garantuara me KEDNJ, po ashtu edhe çështjen e afateve prekluzive në lidhje me ngritjen e aktakuzës.
55. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se ajo në kërkesën KI60/16 tashmë është marrë me tërë këto pretendime dhe se të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara me Aktvendimin për papranueshmëri të 15 nëntorit 2016.

56. Rrjedhimisht, Gjykata të gjitha këto pretendime, të cilat tashmë i ka vlerësuar në kërkesën KI60/16, i konsideron si kërkesë për përsëritje të kërkesës së mëhershme lidhur me çështjet për të cilat Gjykata tashmë ka vendosur.
57. Prandaj, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, Gjykata atë pjesë të pretendimeve nga kërkesa KI159/18, e refuzon si të palejuar, me procedurë të shkurtër.
58. Gjykata dëshiron të theksojë se gjatë vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, ajo në kërkesën e tanishme (KI159/18), do t'i merr parasysh dhe do t'i shqyrtojë vetëm shkeljet e pretenduara në lidhje me: a) *Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 277/2017, të 30 prillit 2018*, b) *Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN. nr. 191/2016, të 1 prillit 2016*, dhe c) *Vendimin e Gjykatës Themelore, PKR-18/2015 të 9 shkurtit 2016*.
59. Gjykata e mori një qëndrim të tillë për arsye se këto aktvendime gjyqësore nuk kanë qenë objekt i vlerësimit kushtetues në kërkesën KI60/16, pasi që aktvendimet në fjalë në atë kohë as që ishin nxjerrë nga gjykatat e rregullta, e kanë të bëjnë me vazhdimin e procedurës penale të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me kërkesën KI159/18

60. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, pasi Gjykata Themelore vazhdoi me procedurën penale me qëllim të vërtetimit të përgjegjësisë së tij penale, gjë që sipas tij është në kundërshtim me KPP-në.
61. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat me vendimin që të vazhdojnë procedurën gjyqësore kundër tij, kanë shkelur disa nene të KPP-së, gjë që rezultoi me shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenet në vijim: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], 36 [E Drejta e Privatësisë], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave], 102 (3) [Gjykata gjykon në bazë të Kushtetutës dhe ligjit], 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
62. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, si bazë për shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, thekson zbatimin e gabuar të KPP-së nga gjykatat e rregullta, duke ngritur kështu çështjen e ligjshmërisë, e cila bie në fushëveprimin dhe juridiksionin e gjykatave të rregullta.
63. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

Gjykata nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-1; rasti nr. KI72/14, parashtruese e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, paragrafi 65).

64. Gjykata gjithashtu rikujton se detyra e saj është të shqyrtojë nëse eventualisht ka pasur shkelje apo neglizhim të të drejtave kushtetuese (e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.) dhe nëse zbatimi i ligjit eventualisht ka qenë arbitrar apo diskriminues (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Koshoglu kundër Bullgarisë*, të 10 majit 2007, nr. 48191/99).
65. Rrjedhimisht, duke i lidhur parimet e cituara të GJEDNJ-së me rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore nxori Vendimin PKR. nr. 18/2015, i cili kishte të bënte vetëm me vazhdimin e procedurës gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës, ku do të vërtetohej përgjegjësia e tij penale. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos e vërej se Gjykata Themelore ende nuk ka vërtetuar faktet në rastin konkret, sepse gjykata i vërteton faktet gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Gjykata Themelore nuk ka mundur që në mënyrë arbitrar të zbatojë rregullat pozitive ligjore në rastin konkret lidhur me vërtetimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës, sepse ajo ende nuk ka marrë vendim lidhur me këtë çështje.
66. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Vendimit të Gjykatës Themelore lidhur me vazhdimin e procedurës gjyqësore.
67. Në lidhje me këtë, Gjykata gjen se Gjykata e Apelit në Aktvendimin PN. nr. 191/2016, vërtetoi se parashtruesi i kërkesës ankohet vetëm në vendimin e Gjykatës Themelore për vazhdimin e procedurës gjyqësore, që vetvetiu përbën çështje procedurale e cila është pjesë përbërëse e gjykimit, dhe i cili ka për qëllim pikërisht vërtetimin dhe shpjegimin e të gjitha rrethanave të rastit si dhe vërtetimin nëse ekziston vepra penale për të cilën parashtruesi i kërkesës akuzohet apo jo, dhe rrjedhimisht nëse ekziston përgjegjësia e tij penale. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit konkludoi se “*Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për çështje procedurale, parashtruesi i kërkesës nuk mund të paraqesë ankesë kundër saj*”.
68. Gjykata më tej vëren se Gjykata Supreme me Aktvendimin PML. nr. 277/2017, refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit si të papranueshme për shkak se procedura në rastin konkret nuk është përfunduar në formë të prerë, por “*ajo ndodhet në fazën e shqyrtimit gjyqësor i cili është urdhëruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 245/2015 më datë 26.11.2015, kështu që në këtë situatë nuk ka përfunduar*

procedura në këtë çështje [...] prandaj kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në këtë rast nuk është e lejuar.”

69. Në lidhje me këtë, Gjykata gjen se Gjykata e Apelit, e më pas edhe Gjykata Supreme, në rastin konkret u morën ekskluzivisht me çështjen procedurale lidhur me vazhdimin e procedurës gjyqësore me të cilën parashtruesi i kërkesës nuk pajtohej dhe rrjedhimisht konkluduan se nuk ekziston mundësia e kundërshtimit të një veprimi të tillë standard, procedural e gjyqësor.
70. Në bazë të gjithë asaj që u tha, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit asgjë nuk tregon se procedurat në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata të bindet se thelbi i së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur dhe se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, që do të rezultonte me shkelje të kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
71. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së, dhe për të justifikuar pretendimin e tij për një shkelje të pretenduar, ai pohon: *“Ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.12 të Konventës, nenit 24 të Kushtetutës, lidhur me diskriminimin e bërë ndaj Azem Duraku pasi që për këtë ekziston përgjegjësia penale ndërsa për ekspertin tjetër Shqipe Hoti për të njëjtën lëndë dhe të njëjtin aktivitet nuk ekziston përgjegjësia penale”*.
72. Në këtë drejtim, Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, fillimisht rikujton që neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës thekson: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”*.
73. Po ashtu, neni 1 i Protokollit nr. 12 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit), i KEDNJ-së thotë: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.
74. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vendimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë penale në Gjykatën Themelore, me asnjë veprim të autoriteteve kompetente (me veprim ose mosveprim), nuk është vendosur në një pozitë të pabarabartë vis a vis gjykatës, prokurorisë apo ndonjë organi tjetër shtetëror, Gjykata gjithashtu nuk konstaton trajtim të ndryshëm të parashtruesit të kërkesës në lidhje me sigurimin e së drejtës së tij në gjykata.
75. Gjithashtu, sa i përket diskriminimit, Gjykata përsërit se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, diskriminimi nënkupton *trajtim të ndryshëm të personave në situata të ngjashme pa arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm* (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.

36042/97, paragrafi 48). Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së lidhur me diskriminim janë të pabazuara. Një qëndrim i tillë është marrë nga Gjykata në bazë të sjelljes së gjykatave të rregullta, sepse nga veprimet e tyre lidhur me vazhdimin e procedurës penale, nuk mund të konkludohet që paditësi në ndonjë moment të caktuar është sjellë para gjykatave në pozitë diskriminuese në raport me të tjerët.

76. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se atij gjithashtu i është shkelur e drejta sipas nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
77. Gjykata rikujton nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës i cili thotë: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*.
78. Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive) i KEDNJ-së gjithashtu parasheh që: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*.
79. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së u garantojnë të gjithë personave se ata mund të përdorin mjetet juridike në mënyrë që të realizojnë të drejtat e tyre pranë autoriteteve kompetente, megjithatë, Gjykata në rastin konkret konstaton që procedura gjyqësore për përcaktimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës ende nuk ka filluar, nga e cila gjë mund të konkludohet se parashtruesi nuk është ende në fazën e shfrytëzimit të mjeteve të rregullta juridike me të cilat do të kontestonte ligjshmërinë e aktgjyqimeve të gjykatave të rregullta në lidhje me merita. Për më tepër, Gjykata vëren se edhe në pjesën procedurale në lidhje me vendimin për vazhdimin e procedurës penale, ai ka pasur mundësi që ta shfrytëzojë ankesën pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, duke e kontestuar vendimin e Gjykatës Themelore. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së janë të pabazuara.
80. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon shkelje të nenit 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (1) të Protokollit Nr. 7 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të KEDNJ-së, duke deklaruar:

“Këtu mund të zbatohet rregulla e njohur ne bis in idem (jo dy herë për të njëjtën çështje), esenca e së cilës ka të bëjë me atë që askush nuk mund të ndiqet, as dënohet për veprën penale për të cilën aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë, apo për të cilën është ndërprerë procedura me vendim të folmes së prerë”.

81. Gjykata, duke analizuar këtë pjesë të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, vërejtë se procedura gjyqësore sipas aktakuzës së prokurorisë se ai ka kryer vepër penale është vetëm në një fazë të hershme, përkatësisht se gjykatat nuk kishin marrë ende vendime përfundimtare mbi përgjegjësinë e tij penale dhe, rrjedhimisht, as nuk kishin marrë vendim për lartësinë e dënimit të tij. Bazuar në sa më sipër, rrjedh se parashtruesi i kërkesës ende nuk është dënuar apo shpallur fajtor, dhe as nuk është ndëshkuar, dhe për këtë arsye Gjykata i gjen të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës dhe nenit 4 (1) të Protokollit 7.
82. Parashtruesi më tej pretendon se gjykatat kanë shkelur nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së sepse *“Në urdhërin e gjykatës të datës 12.10.2012 sa kemi mundur të kuptojmë nuk ka pasur urdhër të merren komunikimet në mënyrë retroaktive me muaj të tërë apo vite. Po ashtu ndaj telefonisë mobile ipko komunikimet kërkohen në periudhën 60 ditore, ndërsa në telefoninë mobile Vala për periudhë më të gjatë retroaktive, kjo konsiderojmë se nuk është ne rregull. Për këtë jemi të bindur dhe konsiderojmë se është shkelur neni 36 i Kushtetutës”*.
83. Gjykata në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit përsërit se ai në kërkesën e tij KI159/18 analizon vetëm aktvendimet e gjykatave në lidhje me vazhdimin e procedurës penale, përkatësisht vendimet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me procedurën, dhe jo vetë meritat. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se nga arsyetimi i vendimeve të kontestuara nuk mund të konkludohet nëse dëshmitë e fituara në mënyrën e pretenduar nga parashtruesi i kërkesës janë në përputhje me ligjin apo jo. Gjykata më tej shton se gjatë procedurës gjyqësore në të cilën do të përcaktohet përgjegjësia e tij penale, parashtruesi i kërkesës në gjykatë do të ketë mundësinë të kundërshtojë provat si dhe materialin e provave, dhe mënyrën në të cilën ato janë mbledhur, dhe gjykatat e rregullta duhet të vendosin nëse kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës janë të bazuara apo jo.
84. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe 102 (3) [Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit] të Kushtetutës, Gjykata në bazë të asaj që është thënë mund të konkludojë se parashtruesi në këtë pjesë të procedurës që analizoi kishte pasur mbrojtje gjyqësore deri në atë masë që ishte parashikuar për fazën e dhënë, që mund të shihet në bazë të të gjitha veprimeve të ndërmarra nga gjykatat. Po ashtu, Gjykata nuk ka mundur të vërejë se mbrojtja gjyqësore e parashtruesit të kërkesës ishte e kufizuar ose e pamundësuar me vendimin e ndonjë autoriteti.
85. Përveç kësaj, Gjykata duke pasur parasysh nenin 102 të Kushtetutës, konstaton se gjykatat në pjesën e procedurës deri më tani kishin ndërmarrë vetëm veprime procedurale për të cilat kishin sjellë vetëm aktvendime për pjesën procedurale të gjykimit, nga e cila mund të konkludohet se në veprimet e deritanishme të gjykatave nuk ka pasur shkelje të Kushtetutës ose ligjit.

86. Gjkata në bazë të asaj që është thënë konstaton se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon që procedurat pranë Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, i kanë shkelur tij në ndonjë mënyrë të drejtat dhe liritë kushtetuese ose të drejtat dhe liritë e garantuara me KEDNJ.
87. Gjkata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështet pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqes dëshmi *prima facie* që tregojnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
88. Prandaj, kërkesa e parashtruesit refuzohet pjesërisht në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përderisa pretendimet në kërkesën KI159/18, refuzohen si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

89. Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjkata të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme "*në mënyrë që procedura penale në Gjykatën Themelore duhet të pezullohet deri në vendimmarrjen nga Gjkata Kushtetuese, sepse konsiderojmë se kjo masë është e nevojshme për të evituar dëmet e pariparueshme të cilat nuk mund të riparohen me vonë, duke vazhduar me mbajtjen e seancave të shqyrtimit gjyqësor.*"
90. Gjkata tani më konkludoi se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese.
91. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 35 (5), 39 (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 prill 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi